



**REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KANCELARI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 10.12.2018

**NJOFTIM**

Sot, ditën e hënë, datë 10 Dhjetor 2018, ora 12.30, në ambientet e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, u hodh shorti për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Votimit që do të administrojnë procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga rradhët e gjyqtarëve.

Ky short u zhvillua nën përgjegjësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori në përputhje me parashikimet e nenit 16, pika 4, fjalia e fundit, të Ligjit nr. 115/2016.

Në hedhjen e këtij shorti, ishin present edhe përfaqësues të institucioneve vëzhguese si; USAID, EURALIUS dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Para fillimit të hedhjes së shortit u verifikua prania e ndihmësmagjistratëve që ushtrojnë aktualisht detyrën pranë Gjykatës së Lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 16, pika 4, fjalia e parë e Ligjit 115/2016, e konkretisht ndihmësmagjistratët Durim Kadiu, Ina Hoxha, Engert Pëllumbi dhe Florian Kalaja.

Fillimisht u hodh shorti për për caktimin e Anëtarëve të Komisionit të Votimit, nga ku u zgjodhën: Engert Pëllumbi, Florian Kalaja dhe Durim Kadiu.

Më pas, u hodh shorti midis tre anëtarëve të zgjedhur të Komisionit të Votimit, për të zgjedhur Kryetarin e Komisionit të Votimit, nga i cili u zgjodh ndihmësmagjistrati Durim Kadiu.

Procesverbali i mbajtur është nënshkruar nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë short.